



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:116617

Datë: 17.10.2023

Numri i dokumentit: 04793313

C.nr.2444/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm– Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala - në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.R nga Peja, të cilin e përfaqëson i autorizuari tij av. M.R nga Peja, kundër të paditurit Sh.K nga Peja, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. A.K nga Peja, me objekt kontesti pengim posedimi, me vlerë të kontestit 500 euro, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 03.10.2023 ndërsa me datë 17.10.2023, përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.R nga Peja, me të cilën ka kërkuar që të **VËRTETOHET** se i padituri Sh.K nga Peja, me datë 14.09.2020, ka penguar paditësin në mënyrë qe nga muri i cili ndan pjesën e parcelës nr.5418-2 pronë e paditësit, nga prona e të paditurit pjesë tjetër të kësaj parcele ka hjek telat e varur nga paditësi mbi mur dhe ka vendosur katër shtylla të betonit, me qëllim të ndërtoj objekt ndërtimor mbi këtë pjesë dhe në këtë mënyrë të privoj paditësin nga pronësia dhe posedimi dhe detyrohet që në afatin menjëherë më së largu brenda 48 orëve të kthej posedimin në gjendje të mëparshme, duke hjek shtyllat e betonit të ngritura mbi mur dhe vuarjen e telit nga e ka hjek dhe shmanget se penguari paditësin në këtë mënyrë, apo mënyrë të ngjajshme nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, **si e pabazuar**.

II. DETYROHET paditësi A.R nga Peja, emër të shpenzimeve procedurale të ja paguaj të paditurit Sh.K nga Peja, shumën prej 779 euro, dhe atë në afat prej 7 ditëve nga dita marrjes se aktvendimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit me objekt kontesti pengim posedimi me vlerë të kontestit 500 Euro.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare dhe në ri procedura ka deklaruar se: mbesim në tërësi pranë padisë dhe pretendimeve të shqyrtimeve të mëparshme si dhe pretendimeve të dhëna në ankese. Posaçërisht theksojmë se me rastin e daljes së gjykatës

ne vend është vërejtur ne mënyrë te veçantë se pjesa kontestuese është ne tërësi e ngjashme si pjesa tjetër e pasurisë se paditësit. Është vërejte qarte se ajo prone është e mbjellur me bar dhe bari ka qene e njëjtë si ne pjesën e cila është prone e paditësit ashtu edhe ne pjesën kontestuese. Prandaj nga ky fakt vërtetohet se paditësi ka qene ne posedim te kësaj pjese qe një kohe, qe nga koha kur e ka blerë pasurinë e tij dhe e ka gjet dhe i është dorëzuar ne këtë gjendej. Prandaj posedimi i tij është i kamotshëm. Përndryshe këtë e ka pasur te ditur edhe i padituri ngase nga ana jugore e pasurisë se paditësit është një pjese e patundshmërisë se paditësit te cilën e shfrytëzon i padituri për qasjen ne shtëpinë e tij nga rruga publike. Pra ndërgjyqësit shfrytëzojnë pasuritë e njeri-tjetrit, paditësi pjesën kontestuese, ndërsa i padituri ne anën jugore një pjesë të pasurisë se paditësit. Këtu është një keqkuptim ngase paditësi të paditurit nuk ia mohon posedimin e pjesës nga shtëpia e tij deri te themeli për te cilin flet i autorizuari i te paditurit. Mirëpo i padituri ka tentuar ta shtriye posedimin edhe në pjesën kontestuese e cila ndodhet përtej këtij themeli. Ai me rastin e pengimit hoqi gardhin i cili ndodhej mbi themel (shtyllat e hekurit me tel) dhe ne këtë mënyrë manifestoj pretendimin e vet për te shtrire posedimin edhe ne pjesën kontestuese. Ndërkaq shihet qarte nga kjo foto se pjesa kontestuese është tërësisht identike me pjese tjetër qe është ne pronësi dhe posedim te paditësit. E lus gjykatën te këtë parasysht vërejtjet nga aktvendimi AC.nr. 1504/22, te dt. 18.07.2023. shpenzimet i ka kërkuar dhe specifikuar.

I autorizuari i të paditurit gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare si dhe në ri procedura ka deklaruar se: mbesim ne tersi pranë deklarimeve nga seancat e kaluara si dhe pranë kësaj seancë te sotme si dhe pranë fjalës përfundimtare te dhënë me dt. 14.01.2022, duke shtuar se vet pala paditëse sot ne seancë e pohoj se nuk është kontestuese posedimi sa i përket pjesës se themelit ku janë te vendosura shtyllat e betonit duke thënë se ka qene dhe është ne posedimi te të paditurit, por sipas palës paditëse i padituri ka tentuar te shtriye posedimin vet fjala ka tentuar vërteton faktin se nuk kemi pengim posedimi ku edhe sot vet paditësi e ka ne posedim përtej themelit sipërfaqen qe sipas tij pala e paditur ka tentuar, andaj tentimi dhe kryerja janë dy bota te kundërta dhe kërkoj nga gjykata qe mbi këtë baze te refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si te pabazuar pasi qe nuk kemi te bëjmë me aktin e pengim posedimit. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë sipas procesverbalit te dt. 14.01.2022, ne shume prej 644 euro duke shtuar edhe seancën e sotme ne shume prej 135 euro e qe ne total janë 779 euro.

Gjykata konstaton se kjo lëndë sipas Aktvendimit të Gjykatës se Apelit të Kosovës me Ac. nr. 1504/2022 i datës, 18.07.2023, është pranuar si e bazuar ankesa e paditësit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr. 1171/20 i datës 31.01.2022, është prishur dhe lënda i është kthyer kësaj gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas udhëzimeve të Gjykatës se Apelit, në ri procedurë ka caktuar shqyrtimin kryesor, dhe sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat ku me propozimin e të autorizuarave të palëve ndërgjyqës janë konstatuar si të lexuara të gjitha provat (shkresat e lëndës) të cilat janë administruar me parë, (në shqyrtimin paraprak C.nr. 1171/20 të datës 14.01.2022), ndërsa nuk ka administruar prova të reja pasi që nuk ka pasur propozime të reja nga palët ndërgjyqëse. Gjykata i vlerësoj edhe deklaratimet e të autorizuarave të ndërgjyqësve të bëra gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7 dhe 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike - kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme me nr. P-71611071-05418-2 ZK Pejë, në sipërfaqe prej 839 metra katrorë, gjykata konstaton se pronar i kësaj paluajtshmërie është Sh. K.

Ne procedurën e mëhershme gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike me propozimin e palës paditëse së bashku me ekspertin e gjeodezisë si dhe palët ndërgjyqës ka dalë në vend dhe në mënyre të saktë ka identifikuar pjesën kontestuese të përshkruar në mënyre të detajuar si në procesverbalin e dt. 25.06.2021 dhe në vend gjykata ka konstatuar se kontestuese mes palëve ndërgjyqës është pjesa e cila ndan ngastrën kadastrale me nr. 5418/2 e të paditurit dhe ngastra kadastrale 5418/24 pronë e këtui paditësit ku shtrirja gjeografike e pjesës kontestuese është përshkruar saktë në procesverbalin, e dt. 25.06.2021, dhe në ekspertizën e ekspertit gjeodet Faruk Hysenaj.

Gjykata në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën e ekspertit gjeodet Faruk Hysenaj dhe sqarimeve të dhëna në seancën e datës 08.12.2021, i cili ka bërë identifikimin, incizimin e gjendjes faktike në vend dhe matjet e paluajtshmeris kontestuese, dhe eksperti kësaj ekspertize ja ka bashkangjitur certifikatat e pronësisë, kopjet e planit me shënime kadastrale, ortofoton e vitit 2009, 2012 dhe 2018, dhe fotot e vendit të ngjarjes, ku ngastra kadastrale me numër të njësisë 5418/2 me kulturë oborr në sipërfaqe prej 500m² pëmishte klasa e parë në sipërfaqe prej 259m² dhe shtëpi në sipërfaqe prej 80m² gjithsejtë 839m² ne cila në evidencë kadastrale evidentohet në emër të K.Sh.Haxhi. Ngastra kadastrale me numër të njësisë 541824 me kulturë oborr në sipërfaqe prej 433m² dhe shtëpi në sipërfaqe prej 47m², gjithsejtë 480m² e cila evidencën kadastrale evidentohet në emër të R.A.A. Këto dy ngastra gjenden në rrugën Para K. N. Pas identifikimit të ngastrës në teren të incizimit të gjendjes faktike të ngastrave lëndore konstatojmë që: Pjesa lindore e ngastrës 5418/2 me sipërfaqe prej 79m² të cekur si në skicën e mbajtjes me ngjarë të kaltër në teren është e bashkangjitur ngastrës 5418/24. Në teren ekzistojnë themelet e betonit nga pika A në jugperëndimore në gjatësi prej 5.48m, pika B dhe nga pika B gjatësi prej 9.92m, pika C nga pika B deri në çikën C janë të vendosura pllakat e betonit mbi themelet të vjetra dhe 4 shtylla të betonit në lartësi prej 2 m, në sipërfaqe prej 79m² është realizuar nga pika A,BC. 2 dhe 1, e përshkruar me gjerësisht në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë.

Nga fotot e bëra në vend gjykata konstatohet hapësirën e pjesës kontestuese që deri në momentin e aktit të pengimit të posedimit ku i padituri ka filluar vendosje e shtyllave të betonit për gjatë themelit të murit i cili shtrihet në ngastrën kadastrale me nr 5418/2 dhe ku i njëjti ka qen pjesë ndarëse e pronës së paditurit me të paditësit.

Gjykata sipas propozimit e palëve ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit të më hershem ne seancën e shqyrtimit kryesor ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve F.R, F.S, Gj.Sh, ku dëshmitarja F.R në seancën e datës 08.12.2021, ka deklaruar se në Qershor të vitit 1985 ne e kemi blerë paluajtshmerinë e cila është në megjë me A. dhe Sh. dhe ai mur ka ekzistuar që nga koha kur ne jemi vendosur aty dhe në atë kohë ka qenë muri i plotë rreth dy metra, mirëpo si pasojë e luftës është rrëzuar muri dhe ka mbetur vetëm themeli, ku mbi atë mure nuk ka pasur asgjë por kanë qenë disa bagrena afër në megjë ku ata bagrena i ka heqë Sh. kur ka filluar me i vendosur shtyllat mbi mur dhe se aj mur ka qenë gjithmonë kufiri mes këtyre dy pronave, dhe atë ditë Sh. i ka thanë A. se do ti sjellë bagrenat që ta rrënoj murin, dhe ta shtyjë megjën për 4 ose 5 metra dhe A. i ka thirrë policinë pasi që i njëjti nuk ka dashur të hyjë në konflikt me të dhe i ka marrë të gjithë dokumentacionin ku të njëjtin ia ka treguar policëve, gjithashtu e njëjta ka deklaruar se nuk e din kujt i ka takuar muri por ai mur i ka ndarë këto shtëpi. Gjithashtu dëshmitari F.S seancën e datës 08.12.2021, ka deklaruar se me A. rrimë gjatë gjithë kohës dhe për atë pjesë të cilën bëhet fjalë A. e ka në shfrytëzim prej 1999, dhe atë ka qenë e vendosur një shtëpi e rrënuar ku A. e ka larguar atë dhe e ka pastruar ku kamë qenë edhe vetë prezentë, dhe muri ka qenë aty nuk e mbaj mend se a ka pasur të vendosur diçka mbi mur apo jo, por A. më ka thënë se këtë mur i takon atij dhe ai e ka pasur në shfrytëzim. Gjithashtu dëshmitarja Gj.Sh në seancën e datës 14.01.2022, ka deklaruar se parcelën të cilën e ka blerë Sh., atë parcelë unë ia kamë gjetur për ta blerë, ku i njëjti këtë paluajtshmeri e ka blerë dhe aty ka ndërtuar shtëpinë, gjatë asaj kohe diku 12-13 viteve i njëjti me ka njoftuar se ku i ka pikat sipas kadastrës dhe ato kanë qenë në brendi të ngastrës tjetër por aty ka qenë një pjesë e themelit të miturit ku edhe një pjesë është tani e rrënuar pasi që e njëjta është vjetër, dhe e njëjta ka deklaruar se murin e ka pasur në shfrytëzim Sh. Gjykata dëshmime të dëshmitareve F.R dhe Gj.Sh i fali besimin në tersi pasi që të njëjtat përputhen edhe me provat të cilat ishin në shkresa të lendes dhe në bazë të këtyre dëshmime konstatohet fakti se ky mur ka shërbyer si mëgje mes pronave të palëve ndërgjyqëse ku dhe muri kontestues ka qenë në shfrytëzim të paditurit. Gjykata nuk i fali besimin deklaratës së dëshmitarit F.S pasi që i njëjti rrethanat për murin ku i njëjti është pjesë e shqyrtimit të aktin e pengim posedimit i deklaroi se i ka dëgjuar nga paditësi ku i njëjti i ka thënë se muri është i tij, për çka deklarata e tij nuk ishte i besueshme për gjykatën.

Gjykata me rastin e vendosjes në riprocedurë pati parasysh sygjyerimet e dhëna në Aktvendim të Gjykatës së Apelit të Kosovës me Ac. nr. 1504/2022 i datës, 18.07.2023, e pas administrimit të te gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 103, 113 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se *“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se *“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”*, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*.

Sipas dispozitës së nenit 480, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shprehimisht parasheh se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321, 322 dhe 480, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar pushtetin e fundit faktik të posedimit për pjesën kontestuese kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar dhe me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar tri kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit në mënyrë komulative e që janë: kushtin e parë pushtetin e fundit faktik, këtë rrethanë se paditësi nuk e ka pasur posedimin gjykata e ka vërtetuar nga dalja në teren dhe gjithashtu edhe vet i autorizuari i paditësit në seancën e datës 03.10.2023 ka deklaruar se: i padituri ka tentuar ta shtrij posedimin edhe në pjesën kontestuese e cila ndodhet përtej këtij temeli. Ku kjo rrethanë u vërtetua edhe përmes dëgjimit të dëshmitares Gjyle Shala ku e njëjta ka deklaruar se murin kontestues e ka pasur ne posedim i padituri. Edhe pse janë plotësuar të dy kushtet tjera mënyra e kryerjes dhe kush është kryer (veprimet e ndërmarra nga i padituri me rastin e largimit të telave), si dhe afateshmërin rezulton se padia të jetë parashtruar brenda afatit prej 30 ditë kur pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, por në mungese të plotësimit të kushtit të parë posedimit, kërkesëpadia e paditësit rezulton të jetë e pabazuar, sepse të akti i pengim posedimit duhet të plotësohen në mënyrë komulative që të tre kushte ligjore që një person të mund të gëzoj mbrojtje ligjore. Pasi që posedimi si term ka të bëjë me pushtetin faktik mbi send dhe nuk i referohet pushtetit juridik, ndërsa pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin në shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrë tjetër të kontestit e sidomos në rastin konkret që nuk ka ekzistuar veprimi ku pala paditësi siç pretendon se i padituri ka tentuar të shtrijë pushtetin përtej murit. Gjithashtu duhet të ketë parasysh faktin se gjykata është e lidhur me kërkesën e palës paditëse duke u bazuar në nenin 2 par 1 të LPK-së. Andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata nuk e përjashton mundësin që paditësi ose i padituri nëse i shpreson suksesit në procedurë, mund ti realizoj të drejtat e tyre pronësorë për pjesën e paluajtshmërisë siç pretendohet në rastin konkret në ndonjë procedurë tjetër kontestimore.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat 449, 452 dhe 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, duke marrë parasysh suksesin e palëve në procedurë, ku lartësia e shpenzimeve të aprovuara të paditurit i referohen për përpilimin e përgjigjes në padi 104,00 euro, për përfaqësim në 4 seanca të mbajtura (5x135), gjithsej shuma prej 779 euro.

Bazuar në nenet, 103, 113 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin 142.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:116617 - C.nr.2444/23, 17.10.2023

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.